



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neni 38 të Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës Nr 03/L-149 , neni 6 të Rregullores nr. 05/2010 e orarit të punës si dhe neneve 40 dhe 41 dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM
PËR ZGJATJEN E ORARIT TË PUNËS PËR SEKTORIN E GJENDJES CIVILE

Neni 1

1. Me këtë Vendim përcaktohet zgjatja e orarit të punës për Sektorin e gjendjes Civile i cili funksionon në kuadër të Drejtoratit për Administratë.
2. Sektori i gjendjes civile për periodën prej datës 09.07.2018 e deri me datën 31.08.2018, do të punojë prej orës 8:00 deri në 18:00 nga e hëna deri të premten, ndërsa ditën e shtunë nga ora 10:00 deri në 14:00.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Administratë.

Arsyetim

Zgjatja e orarit të punës për periodën prej datës 09.07.2018 e deri me datën 31.08.2018, bëhet për shkak të numrit të madh të kërkesave që parashtrohen në këtë Sektor që ndërlidhet me fluksin e ardhjes së mërgimtarëve nga shtetet e ndryshme të botës, të cilët e kanë të nevojshme rregullimin e dokumentacionit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

Drejtorit të Drejtoratit për Administratë
Shefit të Sektorit të Gjendjes Civile
Sektorit për Personel

1Nr. 130-40985

Lipjan, më 05.07.2018

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

